



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Instituti për Planifikim Hapësinor/Institut za Prostorno Planiranje/Institute for Spatial Planning

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Z. Dardan Gashi, Ministër në MMPH Z. Arben Çitaku, UD Sekretar Permanent në MMPH			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Luan Nushi, drejtor në IPH			
NGA/OD/FROM:		Nexhmije Kamberi - Hulumtues profesional Gëzime Grajqevci - Planer profesional			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raport për pjesëmarrjen në Trajnimin Ndërkombëtar			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	12.04.2011
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ ZA AKTIVNOST/ FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ ZA USVAJANJE/ FOR APPROVAL					☐
PËR NËNSHKRIM/ ZA POTPIS/ FOR SIGNATURE					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ ZA VASU INFORMACIJU/ FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Të nderuar,
Të bashkëngjitur gjeni raportin lidhur me pjesëmarrjen në Trajnimin e Avancuar
Ndërkombëtar - LEM 2010, Shkup - Maqedoni.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Raport

Trajnimi i Avancuar Ndërkombëtar – LEM 2010,
Shkup - Maqedoni

Raport

Programi i Trajnimit të Avancuar Ndërkombëtar 2010

“Menaxhimi i Mjedist Lokal në Zonat Urbane”

Organizator: Sida – Sipu International dhe Sweco

Pjesëmarrësit: Kandidatët ishin nga vendet e ndryshme: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Moldavi, Gjeorgji, Bellorusi dhe Ukrainë.

Vendi: Shkup - Maqedoni

Data: 13-25 mars 2011



Hyrje

Shkupi kryeqytet i Maqedonisë i ndërtuar 4000 vjet p.e.s.nga ilirët, përfshin një sipërfaqe prej 1,854 km me 668,518 banorë.

Gjatë periudhës ilire Shkupi ishte kryeqendër e Dardanisë dhe njihej me emrin Skupi. Qytetit të Shkupit i jep pamje karakteristike lumi Vardar si dhe monumentet e trashëgimisë kulturore:

- Ura e gurit në qytetin e vjetër, simboli i qytetit të Shkupit;
- Kalaja e Shkupit e ndërtuar në kohën neolite dhe në kohën e bronzit;
- Hamami i Daut Pashës;
- Stacioni i vjetër hekurudhor;
- Sheshi Skënderbe dhe përmendorja e Skënderbeut;
- Xhamitë e Shkupit ;
- Çarshia e vjetër.



Programi i Trajnimit Ndërkombëtar

Organizata ndërkombëtare suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim Sida mbështetet trajnimin ndërkombëtar Menaxhimi i Mjedisit Lokal në Zonat Urbane i cili organizohet për persona të kualifikuar për të marrë pjesë në procesin e reformës strategjike për tu njohur me metodat e ndryshimit të projekteve.

Programi i trajnimeve të avancuara ndërkombëtare menaxhohet nga personeli i organizatave suedeze ndërkombëtare SIPU International dhe SWECO Company.

Ky program është përqëndruar në mbështetje të projekteve individuale apo ekipore për ndryshime dhe është element për arritjen e konsolidimit demokratik dhe zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik, në harmoni me mbrojtjen e mjedisit.

Programi ka pas për qëllim aftësimin e pjesëmarrësve në fushën e menaxhimit lokal të mjedisit në zonat urbane, mbrojtjen e interesave publike për përmirësimin e kualitetit të mjedisit në vendet e pjesëmarrësve duke e praktikuar dhe zbatuar përvojën suedeze për menaxhimit të mjedisit.

Programi i trajnimit zhvillohet në pesë faza, të cilat organizohen në periudha të ndryshme kohore:

- Faza 1, (25 qershor 2010 deri më 5 shtator 2010) përfshin fazën përgatitore të Projektit për Ndryshim për të aplikuar dhe krijuar kontaktet fillestare në mes të pjesëmarrësve dhe organizatorëve.
- Faza 2, (06-24 shtator 2010) në Suedi përfshin trajnimin e planifikuar me ligjërata, vizitave studimore, ushtrime grupore dhe përgatitjen e projekteve për ndryshim.
- Faza 3, (25 shtator 2010 - 13 mars 2011) përfshin të gjitha aktivitetet të cilat secili pjesëmarrës i ka realizuar për përgatitjen e draft dokumentit të projektit, raportit dhe prezantimit
- Faza 4, (14-25 mars 2011) planifikohet dhe organizohet në njërin nga vendet e pjesëmarrësve në rajon.
- Faza 5, (26 mars - Maj 2011) përfshin fazën përfundimtare gjatë së cilës pjesëmarrësit do të vazhdojnë të marrin mbështetje për projektet e tyre për ndryshimin dhe të përgatisin dhe të dorëzojnë raportet përfundimtare.



Faza 4 - Shkup

Gjatë fazës së katërt të trajnimit të organizuar në Maqedoni gjatë periudhës 13-25 mars 2011 kanë marrë pjesë 24 kandidat nga disa vende të Ballkanit dhe Evropës Lindore.

Në këtë fazë pjesëmarrësit kanë diskutuar lidhur me projektet individuale dhe janë ndjekur leksione mbi çështjet relevante duke organizuar vizita studimore.

Janë prezantuar të gjitha projektet nga secili pjesëmarrës:

Nexhmije Kamberi ka prezantuar projektin me temën -
“Pastrimi i Mbetjeve Industriale në Zonën Urbane të Mitrovocës”.

Gëzime Grajqevci ka prezantuar projektin me temën -
“Planprogrami për Konservimin e Bifurkacionit të lumit Nerodime”.

Vizitat:

- REC- Shkup
- Qendra përkujtimore e çifutëve të- Maqedonisë
- OJQ Sumnal, Shkup
- Komuna e Shtipit
- Qyteti i Ohrit
- Parku Nacional “Mavrovo”



Qyteti i Ohrit

Ohri (Lychnidos) ka qenë një qendër e rëndësishme e krishterizmit, qytet i banuar para dy mijë e katërqind vjet, që gjatë shekujve ka përfaqësuar historinë kishtare të Maqedonisë, të njohur me ndërtimin e kishave dhe katedraleve.

Sot qyteti i Ohrit është një qendër turistike, arkeologjike, qyteti i 365 kishave, me vlera të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore të cilat janë nën mbrojtjen e UNESCO-s që nga viti 1980.

Monumentet e trashëgimisë kulturore janë:

- Teatri –i ndërtuar 2000 vjet më parë;
- Kalaja e Car Samuelit;
- Bazilika e hershme krishtere në Plaoshnik;
- Manastiri i Shën Klimentit në Plaoshnik;
- Manastirit të Shën Naumit e Archangels së Shenjtë;
- Kisha Shën Sofia;
- Kisha e Nënës së Shenjtë të Perëndisë Perivleptos;
- Kisha e Shën Jovan Bogoslav në Kaneo;
- Monumentet islamike;





Arkitektura e pjesës së vjetër e qytetit të Ohrit zë vend të veçantë në fushën e trashëgimisë kulturore e cila karakterizohet me ndërtimin e dyqaneve dhe shtëpive orientale të orientuara në drejtim të liqenit si dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të njohura me mozaikë, ikona dhe afreska të pikturuara nga piktorë të famshëm mesjetar.

Tempulli i katedrales së kryepeshkopisë së Ohrit, kisha e Shën Sofisë, është një galeri afreske e njohur me një arkitekturë magjepsëse, që sot fasada e saj krijon një prapaskenë të jashtëzakonshme të "Festivalit tradicional veror të Ohrit" i cili organizohet çdo vit në teatrin e lashtë helen i njohur që nga periudha romake.

Ohri njihet edhe me monumente islamike, që gjatë periudhës së sundimit osman janë transformuar nga kishat në xhami të bukura dhe të mëdha. Sot këto monumente janë transformuar përsëri në destinimin e mëparshëm duke i konservuar dhe revitalizuar vlerat kulturore historike.

Metodat mbrojtëse të trashëgimisë kulturore gjatë ndërtimit janë aplikuar mbi mbetjet e mureve origjinale nga ana e brendshme dhe e jashtme e mureve të monumenteve të ndërtuara gjatë shekujve.

Monumentet e trashëgimisë natyrore

Monumenti i trashëgimisë së natyrës në qytetin e Ohrit është druri i vjetër (Platanus orientalis), 800-900 vjet i vjetër me gjerësi të trungut deri në 20m, pastaj parku kombëtar "Galicica" që gjendet në mes të dy liqejeve të lashtë të Ohrit dhe Prespës i shpallur që nga viti 1958 për shkak të prezencës së lartë të biodiversitetit të florës dhe faunës.



Mavrova

Mavrova u shpall Park Kombëtar në vitin 1948 në kohën e ish Jugosllavisë si zonë me vlera natyrore me 73.000 ha pyje, kullosa dhe livadhet të larta malore. Territori i parkut shtrihet në komunat: Mavrovë-Rostusha dhe Gostivar, në veri-perëndim të Maqedonisë, në kufi me Shqipërinë dhe Kosovën ku mbulon 663 km² dhe ka një popullsi prej 8.618 banorë. Territorin e parkut e përbëjnë lumenjtë: Bistra, Deshat si dhe malet e Korabit me lartësi mbidetrae 2.764 m.

Në bazë të ligjit për mbrojtjen e natyrës 67/2004 është bërë rishikimi i dokumentit dhe është rihartuar Plani Hapësinor dhe Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Mavrovës.

Parkun e karakterizojnë, peizazhi artistik që e përbën liqeni artificial i Mavrovës rreth të cilit janë të planifikuara vendbanimet brenda kufijve të parku dhe llojllojshmëria e florës dhe faunës si dhe shpella e thellë 22 metra e cila përveq stalatiteve dhe stalakniteve posedon edhe liqenin me pamje të bukur.

Turizmi është zhvilluar sipas objektivave të cilat përfshihen në planin hapësinor dhe menaxhohet dhe ruhet sipas masave mbrojtëse të cilat parashihen në planin e menaxhimit.





Në fund të trajnimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në trajnim u dekoruan me diploma si rezultat i punës së arritur një vjeçare në bashkëpunim me autoritetet suedeze, ekspertë nga sektori privat dhe organizatat e tjera të përfshira në mënyrë aktive në menaxhimin e mjedisit.